

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-177289/21 dt. 26.08.2021, të pronarëve Zenel, Beqir, Shefki, Gani dhe Vesel Dalipi, Fikrije, Dibran dhe Ferat Gjata dhe investitorit N.N.P. ”Standard”, me seli në Prishtinë dhe “Miri” Sh.p.k. me përfaqësues Mirsad Sopjani, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “A-20”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në rr. “Ndue Perlleshi” dhe rr. “Arsi Pipa” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 22.03.2022, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve Zenel, Beqir, Shefki, Gani dhe Vesel Dalipi, Fikrije, Dibran dhe Ferat Gjata me investitor N.N.P. ”Standard” me certifikatë të regjistrimit ARBK 810448507, me përfaqësues Nebih Zariqi, me seli në Prishtinë, dhe “Miri” Sh.p.k. me certifikatë të regjistrimit ARBK 810319344 me përfaqësues Mirsad Sopjani, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-177289/21 dt. 26.08.2021, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesës “4” me etazhitet 2B+P+9ET, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-148677 dt. 21.07.2017, dhe plotësimit dhe ndryshimit të Vendimit të Lejes ndërtimore me numër 05 Nr. 351/05-89440/20 dt. 29.07.2020, në kuadër të bllokut urban “A-20”, të tërësisë urbane “A”, të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1648-1, ZK Matiçan.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugët “Ndue Perlleshi” dhe “Arshi Pipa” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 126, 128, 130, 132, 99 dhe 101 në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njërive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Ar sy e t i m

Pronarëve Zenel, Beqir, Shefki, Gani dhe Vesel Dalipi, Fikrije, Dibran dhe Ferat Gjata dhe investitorëve N.N.P. "Standard" me certifikatë të regjistrimit ARBK 810448507, me përfaqësues Nebih Zariqi, me seli në Prishtinë, dhe "Miri" Sh.p.k. me me certifikatë të regjistrimit ARBK 810319344 me përfaqësues Mirsad Sopjani, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-177289/21 dt. 26.08.2021, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesës "4" me etazhitet 2B+P+9ET, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban "A-20", të tërësisë urbane "A", të Planit Rregullues "Mati 1", në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1648-1, ZK Matičan, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-148677 dt. 21.07.2017, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë, me referencë 09 Nr. 391/01-9911/21 dt. 13.08.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimit mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografii gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Fisnik Lushaku; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Driton Mulaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Lavdit Sherifi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Asmir Hamdi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Bashkim Halabaku; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Nazmi Bajrami, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga Kompania Gjeodezike e licencuar "Geo-Group" Sh.p.k. me nr. të licencës 47;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e

certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumë banesore me afarizëm.


Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-177289/21 DT. 22.03.2022**

Zyrtarja,
Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi



Drejtori,
Arber Sadiki



